REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 985-993/20
Datë/Datum. 02.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar BIBAJ – Exp. Shqyrtues	***Data e autorizimit të ekspertit*** *24.11.2020*	*Data e dorëzimit të raportit* *02.12.2020*

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 20.11.2020, OE "Sallahu"shpk - Kacanik, ka parashtruar ankesë me nr: 985/20, dhe me datën 23.11.2020, OE "Granit"shpk – Istig,me nr.993/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Joos Krasniqi", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndertimi i rrugës Peklen – Shtypeq i vogël – Varri i Sykut faza e dyte" me nr. të prokurimit: 635-20-5416-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Pejë.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 1,497,911,54 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

Pretendimet te OE Sallahu shpk – Kacanik – Dispozitat e shkelura nga AK – Neni 7, 27, 28, 51, 52, 59,, dhe 108/A, te LPP-se.

Në përputhje me Njofitimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit , të publikuar nga AK- Komuna e Pejës, Kompania <'Sallahu"Shpk> me datë 26.10.2020, duke i'u përmbajtur të gjitha specifikimeve teknike dhe profesionale, kushteve dhe kritereve të kërkuara, paraqet ofertën përmes sistemit E-prokurim.

Me datë 04.11 2020 , përmes letrës standarde për tenderuesin e pasuksesshëm njoffcohemi nga Autoriteti Kontraktues ,se tenderi ynë ishte i pasuksesshëm, dhe se kontrata i është :

OE ''Joos & Krasniqi- Bazë"Shpk & " BK-Construction ''Shpk.

Duke shfrytëzuar të drejtën ligjore për qasje në dokumente publike gjegjesisht oferta të dërguara nga operatorët ekonomik lidhur me këtë aktivitet të prokurimit,pas shqyrtimit të ofertës së paraqitur nga OE i shpallur si fitues :'Joos & Krasniqi- Bazë"Shpk & '' BK- Construction ''Shpk., vërejmë se AK kontraktues ka shpallur fltues një operatorë ekonomik të papërgjegjshëm Duke qenë palë me interes dhe e dëmtuar, si dhe duke pasur para vetes faktet dhe
dëshmitë se me rastin e shpalljes së OE Fitues, AK Komuna e Pejës nuk e ka përfillur ligjin dhe rregullat dytësore të prokurimit publik, ne parashtrojmë Kërkesë për Rishqyrtim me të gjitha dëshmitë, duke kërkuar që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në rivlerësim.
Mirëpo, me datë 11.11.2020 pranojmë vendimin nga AK Kontraktues , lidhur me kërkesën për Rishqyrtim të OE Sallahu Shpk, me të cilin vendim e refuzon kërkesën tonë. Autoriteti Kontraktues nuk e ka shqyrtuar asnjë pikë ankimore të kërkesës sonë, dhe arsyetimi i refuzimit të kërkesës është krejtësisht i pa bazuar dhe jo profesional; ' *AKkëto çështje i ka marrë si të kalueshme, gjithnjë duke marrë në konsideratë kursimin dhe ruajtjen e parasëpublike"* , duke i'u referuar nenit 59 pika 4 të LPP-së.

Dhe pikërisht ky nen, pra neni 59 pika 4 të LPP-së, trajton çështjen se ,për t'u konsideruar tender i përgjegjëshëm, duhet që të jetë në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit, me kërkesat dhe specifikimet teknike dhe i cili i përmbush kriteret e përzgjedhjes dhe pra OE i shpalluar fitues, ofertën e tij nuk e ka në pajtueshmëri me Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, dhe si të tillë e bëjnë operatorë ekonomik të pa përgjegjshëm ,tutje ky nen i referohet gabimeve,korrigjimeve dhe devijimeve që Autoriteti Kontraktues mund t'i pranojë , në rast se nuk shkaktojnë ndryshime materiale nga kushtet dhe kërkesat e dosjes së tenderit. Siç mund të shihni më poshtë në pikat ankimore, që çdo '[5]korigjim"në këtë dosje do të paraqitste ndryshim material nga kushtet, karakteristikat dhe kërkesat e dosjes se tenderit,madje nuk mund të cilësohen si ''devijime të vogla" apo gabime. Ndryshimi në paisje dhe specifikimet teknike, ndryshimi në menaxher të projektit, në gjeodet a nuk konsiderohet ndryshim thelbësor e material i ofertës sipas AK?! Meqënse vetë Autoriteti Kontraktues i ka përcaktuar këto kushte dhe kritere ne Dosjen e tenderit, dhe nëse mos plotësimin e tyre e konsideron si çështje të kalueshme, ka shkelur nenin 28 të LPP dhe vetë këtë dosje të tenderit.
<u>OE i shpallur fitues : 'Joos & Krasniqi- Bazë"Shpk & BK-Construction ''Shpk në</u> Menaxheri i Projektit të jetë master shkence (MSC)i ndërtimtarisë ose (inxhiner i ndërtimtarisë) drejtimi Infrastrukturë Rrugore apo Konstruktiv , më së paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku 3 projekte të natyrës së njejtë (rikonstruimi ose ndërtimi i rrugëve) - Dëshmi letër referencat për së paku 3 projekte të përfunduara në fushën e rikonstruimit ose ndërtimit të rrugëve.

OE i shpallur fitues ka prezantuar si Menaxher të Projektit ing.Arsim Rapuca. Në referencat që i ka ofruar si dëshmi, ka prezantuar referenca të cilat nuk kanë të bëjnë rne menaxhim në fushën e ndërtimit - rikonstruimit të rrugëve , dhe me këtë rast kjo pikë nuk është në pajtim me kërkesat e AK, dhe si i tillë menaxheri i projektit nuk i përmbushë kushtet dhe kriteret e vendosura nga AK.
Referenca e lëshuar nga Cad - Engineering ka të bëjë me hartim të projekteve. Referenca e lëshuar nga Holl International - Arsim Rapuca ka qenë i angazhuar si inspektor mbikëqyrës i urës dhe kontrollit të kualitetit (referencë kjo e pa pranueshme,pasi nuk është kërkuar referencë në fushën e ndërtimit të urave) Referenca e lëshuar nga Links Projekt Studio ka të bëjë me hartim të dizajnëve për renovimin e ndërtesave publike.
Referenca e lëshuar nga Pro-Cad-Ing se Arsim Puca ka qenë projektant në hartimin e projekteve për ndërtim të strukturave , njësoj edhe referenca e Infra-Ing , janë të gjitha të cilat nuk e përmbushin kërkesën e

Autoritetit Kontraktues që menaxheri të ketë dëshmi letër referencat për së paku 3 projekte të përfunduara në fushën e rikonstruimit ose ndërtimit të rrugëve, dhe jo në hartim të projekteve, menaxhim të urave etj.

2. Në Dosje të Tenderit , lidhur me kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale ,kërkesa nr 5 ; Gjeodeti të jetë inxhiner i diplomuar i gjeodezisë ose Master Shkence (MSC) i gjeodezisë më së paku 3 vite përvojë pune pas diplomit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku 2 projekte të natyrës së njejtë rikonstruimi ose ndërtimi i rrugëve.
Dëshmi ; Për gjeodetin , diploma e skanuar nga origjinali ose kopja e noterizuar si dhe licenca e skanuar nga origjinali ose kopja e noterizuar, dhe kontrata e punës , si dhe letër referencat për së paku dy projete të përfunduara në fushën e rikonstruimit ose ndërtimit të rrugëve. CV-në e nënshkruar nga vetë ing.

OE i shpallur fitues ka prezantuar ing.e gjeodezisë Ramiz Selmani, për të cilin sipas kërkesës mungon licenca e skanuar nga origjinali ose kopja e noterizuar. Edhe kjo pikë nuk është në pajtim ine kërkesën e Autoritetit Kontraktues Në Dosje të Tenderit, lidhur me kërkesat mbi inundësit teknike dhe/ose profesionale , kërkesa nr. 8 , gjegjësisht ANEKS 1 liston paisjet të cilat duhet ti paraqesin OE, të cilat duhet të dëshmohen me Iibrezën e regjistrimit, ndërsa paisjet e tjera OE duhet t'i dëshmojë me ndonjë dokument për pronësinë e tyre ; (faturë, DUD etj)

Në pikën 2 , të Aneks X kërkohet - ° Eskavator ine rrota me peshë min 15-20tona me çekan hidraulik" 1 copë.
-OE i shpallur fitues , ka ofruar pasijen ; Eskavator, marka Fiat Hitachi , tip EX 512W K763, i cili vërtetohet me D.U.D -in e bashkangjitur ,dhe përshkrimin në Aneks 1 Pesha e eskavatorit është 24,000.00(kg), dhe jo ashtu siç kërkohet nga Autoriteti Kontraktues 15-20 tonë.

3. Në pikën 7 të Aneks 1 kërkohet : ''Cilindër min 16-20 ton ine dhëmbëza vibrues"- 1 copë.
OE i shpallur fitues ka ofruar paisjen sipas D.U.D dhe fotografisë së bashkangjitur ; Rul për shtrimin e rrugëve, jo vibratorë , marka ; Amman, tip ASC200HDPD , me peshë 21,975.00(kg) Lidhur me këtë pikë OE i shpallur fitues ka ofruar pasijen e cila nuk i përgjigjet kërkesës së AK, pra është rul pa dhëmbëza(siç dëshmohet edhe me foton e bashkangjitur), jo vibratorë dhe kapaciteti i paisjes nuk i përgjigjet kriterit të kërkuar prej (16-20ton), por është 21,975.00kg. Në pikën 10 të Aneks 1 është kërkuar : ''Auto mikser për transport të betonit" 1 copë. OE i shpallur fitues lidhur me këtë kërkesë të AI< ka ofruar dy paisje krejtësisht të tjera, pra të cilat nuk janë Automikser per transport të betonit ,mirëpo që të dy paisjet janë '' Autopoinpë '' siç vërtetohet edhe nga librezat e bashkangjitura (të skaduara)

1. Autopompë , Fiat, viti 2000, nr.targave 03-406-BL
2. Autopompë, Fiat, viti 1994, nr.targave 03-408-BL

4. Në pikën nr.16 të Aneks 1 është kërkuar; ''Cilindrat me rrota të kombinuara (goinë&hekur)min 6-8ton , 1 copë.
OE i shpallur fitues ka ofruar paisjen e cila vërtetohet D.U.D dhe sipas fotografisë së bashkangjitur. Pasija ; Rul për shtrimin e rrugëve , vibratorë, marka ; Hamin , tip DV7VO. Kjo paisje nuk është cilindër me rrota të koinbinuara gomë dhe hekur, mirëpo është cilindër me rrota hekur-hekur ashtu siç dëshmohet edhe nga fotografia e bashkangjitur, me këtë rast kjo paisje nuk është në përputhje me kërkesën e Autoritetit Kontraktues.
5. Në pikën nr.20 të Aneks 1 është kërkuar '' Autocisternë(autobot)për ujë, 2 copë. OE i shpallur fitues për

këtë pikë ka ofruar paisjen e cila nuk është Autocisternë për ujë, inirëpo Kamion për pastrimin e rrugëve (dy dyer) e cila vërtetohet sipas librezës së bashkangjitur ; Mercedes Benz , tip 914-KO, me nr. të targave 03-708-FB, dhe
sipas fotografisë së bashkangjitur nmnd të shihni se paisja është Kamion për pastrimin e rrugëve.

Të gjitha pikat e Iartëcekuar nuk janë në pajtueshmëri me kushtet dhe kërkesat Njoftimit për Kontratë dhe Dojses së tenderit nga Autoriteti Kontraktues dhe si i tillë OE 'Joos & Krasniqi- Bazë"Shpk & '' BK-Construction duhet të shpallet i pa përgjegjshëm dhe të eliminohet nga procedura e prokurimit , dhe jo të shpërblehet me kontratë.

Nga të dhënat e lartëcekura dhe dëshmitë e bashkangjtura, Autoriteti Kontraktues, ka shkelur nenet e Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës, duke shpallur fitues një Operator Ekonomik , duke ofruar paisje qe nuk i përgjigjen kushteve dhe kritereve te dosjes se tenderifdhe lidhur me stafin profesional nuk jane në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit, pasi që me rastin e vlerësimit, është shkelur neni 28, lidhur me nenin 59,pika 4, ku thuhet se Autoriteti kontraktues do ta konsideroj të përgjegjshëm një tender vetëm nëse tenderi në ijalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit.
Në mbështetje të nenit 52 të LPP , vetëm kriteret e përcaktuara paraprakisht në dosje të tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim.
Nenet 51, 52 lidhur me nenit 56 obligojnë Autoritetet Kontraktuese që në përzgjedhje të kontratës të vlerësojnë fillimisht kandidatët sipas kërkesave të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas parag.2 te nenit 52 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28, e pastaj të vlerësohet në përputhje me nenin 60 të LPP-së , që lë të kuptohet se në këtë rast , pavarësishtë se OE Joos & Krasniqi-Bazë Shpk & ; BK-Construction Shpk ka paraqitur ofertë me çmimin më të lirë , fillimisht vlerësohet sipas nenit 51.2 dhe 28 të LPP-së , pra kushtet dhe kërkesat e përcaktuara të dosjes, dhe në rast se përmbushen këto kritere parësore, atëherë të vazhdohet tek pjesa e çmimit të ofertës.
Siç shihet nga faktet të cilat i posedojmë , dhe i keni të bashkangjitura OE i shpallur fitues nuk i ka përmbushur kushtet dhe kriteret e dosjes së tenderit.

Andaj duke pasur parasysh të gjitha shkeljet e lartëcekura, lidhur ine vlerësimin dhe rekoinandimin për OE fitues në këtë aktivitet të prokuriinit, kërkojmë që kjo procedurë të kthehet në rivlerësim

DEKLARATA DETALE NE ANKESE.
Pretendimet te OE Granit shpk – Istog – Dispozitat e shkelura nga AK –
Neni 59, 64 dhe 66, te LPP-se.

DEKLARATA DETALE NE ANKESE.

AK duke u thirrur ne nenin 59 pika 4 (devijime te vogla) e ka refuzuar kerkesen tone per rishqyrtim ne menyre te padrejte.
Sepse, sipas nenit 59 pika 4 devijimet e vogla: "*nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*"

Duke ju referuar argumenteve qe do te paraqesim ne vijim per ofertuesit e shpallur te pergjegjshem dhe te pershtatshem nga ana e AK-Komuna Peje, lehte mund te shihet se per shembull:
Nuk eshte devijim i vogel dhe qartesisht paraqet ndryshim material nese:

- Menaxheri i propozuar per kontrate nuk ka ofruar asnje letër reference për së paku 3 projekte të përfunduara në fushën e rikonstruktimit ose ndërtimit të rrugëve.
- Ne vend te Certifikates për dhënien e provimit profesional nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, e lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale OE ofertues ofron Certifikate trajnimi e leshuar nga nje Kompani private nga Tirana
- Nese ne vend te cilindrit me rrota te kombinuara (gome dhe hekur) ka ofruar cilinder me dy rrota hekuri
- Ne vend te cilindrit per pune te asfaltit me rrota hekuri (me peshe 8-10 tona) ka ofruar cilinder per ngjeshjen e dheut dhe zhavorit (me peshe 12 tona).
- Nese ne vend te cilindrit me peshe minimum 16 tona (sic eshte kerkuar ne DT) ka ofruar cilinder me peshe 12.7 tona, etj.

Eshte evidente se keto dhe argumentet tjera te detajuara ne vazhdim, ne fakt paraqesin ndryshime materiale dhe devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. (neni 59.4 i Ligjit si dhe neni 47.20 i RRUOPP: "Nëse një devijim është material apo edhe çdo devijim tjetër do të varet nga formulimi konkret i dosjes së tenderit."
Ndersa sa i perket arsyetimit te AK – Komuna Peje se ka vepruar: "*duke e marre ne konsiderate ruajtjen dhe kursimin e parasë publike*", kjo nuk qendron, ngase AK megithate gjate vleresimit te tendereve: *"do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"*
AK nuk ka te drejte te ndyshoje kerkesat e vendosura ne DT pas hapjes se tenderit.
Tek e fundit AK, ne DT ka mundur te kerkoje vetem çmimin me te lire duke mos paraqitur asnje kerkese apo specifikim teknik. Mirepo, perderisa ne DT ka parashtruar kerkesa dhe ka kerkuar deshmi te caktuara, gjate vleresimit duhet ti permbahet atyre kerkesave dhe deshmive te kerkuara.

Ne vazhdim po ju paraqesim deshmite per mungesat e verejtura me rastin e qasjes ne dosjet e tenderit te OE ofertues ne kete aktivitet prokurimi:

1. Ofertuesi i shpallur fitues Grupi i OE JOOS & KRASNIQI – BAZE SH.P.K. & BK-Construction Sh.p.k
Eshte i papershtatshem nga aspekti i kapacitetit teknik dhe professional per keto arsye:
1.1 Menaxheri i kontrates i nominuar nga ky Grup i OE, nuk ka deshmi se ka kryer asnje projekt ne fushen e rikonstruktimit ose ndertimit te rrugeve – mungojne letër referencat për së paku 3 projekte të përfunduara në fushën e rikonstruktimit ose ndërtimit të rrugëve.
Bazuar ne CV-ne e tij dhe ne Referencat e bashkengjitura, shihet se ka referenca ne fushen e projektimit te rrugeve, urave dhe ne mbikqyrje, por nuk ka asnje projekt te kryer ne rikonstruktimin apo ndertimin te rrugeve.

1.2. Te makineria e kerkuar, pozicioni 16 eshte kerkuar *"Cilinder me rrota te kombinuara (gome dhe hekur) min. 6 - 8 tona"*, eshte ofruar Cilinder i markes HAMM Tipi DV70VO ne marreveshje me NNT A.B.C. Clindri i ofruar nuk ploteson kerkesen sipas DT, ngase nuk eshte cilinder me rrota te kombinuara (gome dhe hekur). Cilindri i ofruar eshte cilinder me dy rrota hekuri, pra jo sic eshte kerkuar! Deshmine per kete (ekstrakt nga katalogu i prodhuesit) e gjeni te bashkengjitur ne fletet vijuese – sqarime shtese – pika 1.2

1.3. Te makineria e kerkuar, pozicioni 6 eshte kerkuar *"Ngarkues, kapc. min. 2 – 3 m³"* - 1 copë
Edhepse ne vend te 1-cope, Grupi i OE ka ofruar 3 cope ngarkues, asnjeri nga ta nuk eshte i kapacitetit 2-3 m³.
Ngarkuesi i ofruar WL 48 bazuar ne katalogun e prodhuesit ka lugë me kapacitet 0.75 m³.
Ndersa dy ngarkuesit tjere te ofruar LIEBHERR Tip L574, bazuar ne shenimet nga katalogu i prodhuesit kane kapacitet luge prej 4.5 deri ne 8.5 m³.
Katalogjet e cekuar jane te bashkengjitura ne fletet vijuese – sqarime shtese – pika 1.3
Prandaj, ngarkuesit e ofruar nuk e kane kapcitetin sic eshte kerkuar ne DT dhe rrjedhimisht Grupi i OE eshte i papershtatshem edhe per kete arsye.

2. Ofertuesi i shpallur i pergjegjshem SALLAHU SH.P.K. gjithashtu eshte i papershtatshem nga aspekti i kapacitetit teknik dhe professional per arsyet vijuese:
2.1 Per personin pergjegjes per siguri dhe shendet ne pune, ne DT si deshmi eshte kerkuar Certifikata për dhënien e provimit profesional nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, e lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ne vend te saj, OE SALLAHU ka ofruar nje Certifikate trajnimi per Ilmi H. Fetaj e leshuar nga nje Kompani private nga Tirana (AQSCERT Sh.p.k.). Certifikata e tille as nuk eshte e leshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e as nuk eshte certificate per dhenien e provimit professional. Si e tille nuk permbush kerkesen e specifikuar ne DT
2.2 Inxhinieri udheheqes i nominuar nga OE SALLAHU Ermir Hasani ne CV-ne e tij (te nenshkruar prej tij) ka listuar kompanite ku ka punuar dhe prej vitit 2016 e tutje deklaron se eshte i punesuar te Kompania Viktoria Invest.
Askund ne CV-ne e tij nuk figuron OE SALLAHU. Megjithekete, OE SALLAHU ne DT per Inxhinierin Ermir Hasani ka bashkengjitur disa referenca se kinse ky inxhinier ka punuar edhe per OE SALLAHU. Perderisa vete Inxhinieri (sipas CV-se se tij) ne listen e projekteve ku ai ka qene pjesemarres nuk ka evidentuar asnje projekt me OE SALLAHU, eshte me se e qarte se referencat e leshuara nga OE SALLAHU per Inxhinierin Ermir Hasani jane fiktive. Si te tilla nuk permbushin kerkesen e specifikuar ne DT.

2.3 Per Gjeodetin ne DT si deshmi eshte kerkuar CV-ja e nenshkruar nga vete inxhinieri dhe referencat per se paku 2 (dy) projekte të përfunduara në fushën e rikonstruktimit ose ndërtimit të rrugëve.
Bazuar ne CV-ne e dorezuar ne DT, gjeodeti Fadil Shehu ne periudhen prej vitit 2008 e deri me 2019 kur eshte nenshkruar CV, eshte ne marredhenie pune ne Kompanine Gjeodezike "INFRA &Co.Group" nga Drenasi dhe gjate kesaj kohe nuk ka asnje projekt te kryer ne ekzekutim - rikonstruktim apo ndertim te rrugeve. Per me teper, ne CV-ne e tij askund nuk eshte evidentuar se ka qene i angazhuar ne projektet e rrugeve nga OE SALLAHU. Megjithekete, OE SALLAHU ne DT ka bashkengjitur disa referenca te leshuara per gjeodetin Fadil Shehu se kinse ka punuar ne disa nga projekte e tij ne ndertim te rrugeve.
Perderisa vete gjeodeti ne CV-ne e tij deklaron se qe nga viti 2008 e ne vazhdim eshte i punesuar ne kompanine gjeodezike "INFRA &Co.Group" nga Drenasi (dhe jo te SALLAHU Shpk) dhe ne listen e projekteve ku ai ka qene pjesemarres (sipas CV) nuk figuron asnje projekt me OE SALLAHU, eshte me se e qarte se referencat e leshuara nga OE SALLAHU per gjeodetin Fadil Shehu jane fiktive. Dhe si te tilla nuk permbushin kerkesen e specifikuar ne DT.

2.4 Tek Lista e makinerise, tek pajisjet e nevojshme per punet e asfaltit, ne rubriken me nr. 17. eshte kerkuar: *"Cilinder me rrota hekuri me vibrim me peshe min. 8 - 10 tona"* - *2 cope*
OE SALLAHU per kete pozicion ka ofruar ne piken 17.2 Cilinder Bomag 213-2 me nr. Serik 101400850127 i marre me qira nga FER PETROL. Ky lloj cilindri nuk eshte cilinder me rrota hekuri e as nuk eshte cilinder

per ngjeshje te asfaltit dhe ka peshe 12 tona e jo sic eshte kerkuar 8-10 tona. Rrjedhimisht nuk eshte permbushur kerkesa sipas pikes 17 te lista e pajisjeve per punet e asfaltit. Deshmine per kete (fotografite e ketij lloj cilindri) e gjeni te bashkengjitur ne fletet vijuese – sqarime shtese - pika 2.4.

3. Ofertuesi i shpallur i pergjegjshem RSM SH.P.K. gjithashtu eshte i papershtatshem nga aspekti i kapacitetit teknik dhe professional per arsyet vijuese:

3.1 Per Gjeodetin, ne DT si deshmi eshte kerkuar CV-ja e nenshkruar nga vete inxhinieri dhe referencat per se paku 2 (dy) projekte të përfunduara në fushën e rikonstruktimit ose ndërtimit të rrugëve.
Bazuar ne CV-ne e dorezuar ne DT, gjeodeti Shaqir Kuçi ne periudhen prej vitit 2004 e deri me 21.10.2020 kur eshte nenshkruar CV, eshte ne marredhenie pune ne Kompanine N.P.N. Via Com.
Projektet e cekura ne dy referencat e leshuara nga Kompania BENI COM nuk figurojne askund ne listen e projekteve te cekura ne CV-ne e nenshkruar nga vete gjeodeti. Prandaj, perderisa referencat e bashkengjitura per gjeodetin Shaqir Kuçi nuk korrespondojne me listen e projekteve sipas CV-se se nenshkruar nga vete gjeodeti, mund te konsiderohen se jane fiktive. Si te tilla nuk permbushin kerkesen e specifikuar ne DT.

3.2 OE RSM per 24 cope makina te paraqitura ne listen e makinerise ka lidhur Marreveshje bashkepunimi me MINERAL L.L.C. Mirepo, sipas DT, në rast se OE nuk posedon ndonjë nga pajisjet e kërkuara, duhet te ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Eshte evidente se per pajisjet te cilat jane prone e MINERAL L.L.C., OE RSM nuk ka ofruar marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. (Marreveshja e bashkepunimit nuk eshte marreveshje per marrjen me qira!!)

3.3 Te makineria e kerkuar, pozicioni 7. eshte kerkuar *"Cilinder min. 16-20 tona me dhembeza vibrues" – 1 cope*
Edhepse ne vend te 1-cope sa eshte kerkuar, OE RSM ka paraqitur 2 cilindra, asnjeri nga ta nuk permbush kerkesat e specifikuara ne DT, ngase:
3.3.1 Cilindri i ofruar Dynapac CA302 – Mineral sipas katalogut te prodhuesit ka peshe operative prej 12.7 tonash dhe jo se paku 16 tona sa eshte kerkuar. Deshmine per kete (ekstrakt nga katalogu i prodhuesit) e gjeni te bashkengjitur ne fletet vijuese – sqarime shtese – pika 3.3.1.
3.3.2 Cilindri i dyte i ofruar Cilinder Atlas Copco – Mineral - Duke u bazuar ne kontraten e lidhur mes RSM Shpk dhe MINERAL LLC per bashkepunim dhe ne deshmine e pronesise se makinerise nga ana e MINERAL LLC – faturat e blerjes, shihet se ne secilen nga dy faturat e bashkengjitura figuron nga nje cilinder Dynapac CA4600D. Ky cilinder nuk ploteson kerkesen e DT, ngase pesha operative e tij (sipas katalogut te prodhuesit ne vijim) eshte 13.7 tona dhe jo sic eshte kerkuar (min.16 t). Shih sqarime shtese – pika 3.3.2.
3.4 Tek Lista e makinerise, tek pajisjet e nevojshme per punet e asfaltit, ne rubriken me nr. 17. eshte kerkuar: *"Cilinder me rrota hekuri me vibrim me peshe min. 8 - 10 tona" -2 cope*
Ofertuesi RSM ka ofruar 2 cilindra:

1. Bomag BW 161 AD4

Ky cilinder ploteson kerkesen e DT, sepse eshte cilinder me rrota hekuri per ngjeshje te asfaltit dhe ka peshen prej 9.7 tonash.

2. Cilinder Bitelli 10 ton – Oruci

Sipas dokumenteve te ofruara ne DT, ky cilinder eshte marre me qera nga Firma Oruci dhe si deshmi e pronesise se Firmes Oruci, OE ofertues RSM ka bashkengjitur edhe kontraten e blerjes se tij ndermjet Firmes Oruci dhe Firmes Mali.

Sipas shenimeve te kesaj kontrate, behet fjale per Cilinder (Rul) Bitelli tipi C 120. Edhepse ne kontrate eshte shkruar "Rul vibrues 10 tonesh", e verteta eshte se cilindri i Markes Bitelli Tip C 120 nuk eshte cilinder me rrota hekuri e as nuk eshte cilinder per ngjeshje te asfaltit dhe ka peshe 12 tona e jo sic eshte kerkuar 8-10 tona. Rrjedhimisht nuk eshte permbushur kerkesa sipas pikes 17 te lista e pajisjeve per punet e asfaltit. Deshmine per kete (ekstrakt nga kontrata dhe fotografine e ketij lloj cilindri) e gjeni te bashkengjitur ne fletet vijuese – sqarime shtese – pika 3.4

3.5 Tek Lista e makinerise, tek pajisjet e nevojshme per punet e asfaltit, ne rubriken me nr. 18. eshte kerkuar: *"Cilinder me rrota hekuri me vibrim me peshe min. 10 tona"*

OE RSM ne kete pozicion ka ofruar 2 (dy) clindra:

3.5.1 VIBROMAX W1102 - Ky cilinder, nuk eshte me rrota hekuri dhe perdoret per ngjeshje te dheut dhe zhavorit, por jo edhe per ngjeshje te asfaltit dhe si i tille nuk permbush kerkesen e specifikuar ne DT – pajisje per punet e asfaltit - cilinder me rrota hekuri. Deshmine per kete (fotografi te ketij lloj cilindri) e gjeni te bashkengjitur ne fletet vijuese – sqarime shtese – pika 3.5.1

3.5.2 Dynapac CC222

Cilindri i ofruar Dynapac CC222 eshte cilinder per ngjeshje te asfaltit, mirepo pesha e tij nuk permbush kerkesen e peshes minimum 10 tona. Ky cilinder ka peshe operative prej 7.700 kg dhe peshe maksimale prej 8.400 kg. Deshmine per kete (ekstrakt nga katalogu i prodhuesit) e gjeni te bashkengjitur ne fletet vijuese – sqarime shtese – pika 3.5.2

Bazuar ne faktet e mesiperme dhe sqarimet shtese te bashkengjitura me kete ankese, kerkojme nga OSHP qe Operatoret Ekonomik perkatesisht Grupet e OE ofertues te cekur me lart te shpallen te papershtatshem dhe lenda te kthehet ne rivleresim.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjajëshme në vler prej 2.000.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjajshme të realizuara në 3vitet e fundit.

Kërkesa 2 Të paraqitët stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafinprofesionale. - Stafi teknik (PUNONJËS) që do të kyçet në projekt -minimumi 20 punonjës

Kërkesa 3 Menaxheri i projektit të jetë Master shkence (Msc) i ndërtimtarisë (ose Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë) Drejtimi Infrastrukturë rrugore apo Konstruktiv, me së paku 5 (pesë) vite përvojë pune pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku tri (3) projekte te natyres se njejte (rikonstruktimi ose ndërtimi i rrugëve).

Kërkesa 4 Udhëheqësi i punishtes të jetë Master shkence (MSc) i ndërtimtarisë (ose Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë) Drejtimi Infrastrukturë rrugore, me së paku 5 (pesë) vite përvojë pune pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte te natyres se njejte (rikonstruktimi ose ndërtimi i rrugëve).

Kërkesa 5 Gjeodeti të jetë inxhinjer i diplomuar i gjeodezise ose Master shkence (Msc) i gjeodezise me se paku 3 (tre) vite pervoje pune, pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte te natyres se njejte (rikonstruktimi ose ndërtimi i rrugëve).

Kërkesa 6 OE ofertues duhet te ketë së paku një person të certifikuar për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Kërkesa 7 Operatori ekonomik (në rast të Grupit të OE, së paku udhëheqësi i grupit) duhet të dëshmojë se

sistemi manaxhues i ofertuesit përmbush kriteret e përcaktuara në fushën e ndërtimit të rrugëve së paku për këto ISO standarde - ISO 9001 2015 - Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë – ISO 14001 2015- Sistemi i Menaxhimin Mjedisor.
Kërkesa 8 Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit ne dosje te tenderit tek Aneksi 1

DESHMIA DOKUMENTARE
Dëshmia 1 Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosies së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të punëve.
Dëshmia 2 Lista e punëtoreve me para kontrata minimum 20 punëtorë ose me Liste të ATK-së,
Dëshmia 3 Për menaxher të projektit , diploma e skanuar nga origjinali ose kopja e noterizuar, kontrata e punes, (në rast të angazhimit për këtë projekt, kontrata e menaxherit me ofertuesin duhet të jetë e noterizuar dhe e nënshkruar nga të dy palet në prezencë të noterit) dhe letër referencat për së paku 3 projekte të përfunduara në fushën e rikonstruktimit ose ndërtimit të rrugëve. CVnë të nenshkruar nga vet ingjinjeri
Dëshmia 4 Për udhëheqës të punishtes , diploma e skanuar nga origjinali ose kopja e noterizuar, kontrata e punes dhe letër referencat për së paku 2 projekte të përfunduara në fushën e rikonstruktimit ose ndërtimit të rrugëve. CV-në të nenshkruar nga vet ingjinjeri
Dëshmia 5 Për gjeodetin , diploma e skanuar nga origjinali ose kopja e noterizuar si dhe licenca e skanuar nga origjinali apo kopja e noterizuar dhe kontrata e punes, si dhe letër referencat për se paku 2 projekte të përfunduara në fushën e rikonstruktimit ose ndërtimit të rrugëve. CV-në të nenshkruar nga vet ingjinjeri
Dëshmia 6 Certifikata për dhënien e provimit profesional nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, e lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (e skanuar nga origjinali ose kopja e noterizuar). Vërejtje! (kerkesa 3 - 6) Nëse Operatori Ekonomik nuk ka në përbërjen e stafit të tij ndonjë nga personeli i lartcekur (3 - 6), atëherë mund të angazhoj ata – si dëshmi të prezantojë Kontratë pune ose marrëveshje per punë me punëdhënësin të noterizuar, duke specifikuar titullin e këtij projekti dhe nr. e prokurimit. Kontrata e tillë duhet të nënshkruhet nga të dy palët në prezencë të noterit.
Dëshmia 7 Certifikatat valide për ISO standardet e kërkuara në fushën e ndërtimit të rrugëve, të skanuara nga origjinali.

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

AK – Komuna Peje, ka rekomanduar per dhënie te kontratës OE, Joos Krasniqi

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

NA

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË ANKESAVE

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues/ Komuna Peje, gjate këtij aktiviteti te prokurimin ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është pune, kontratë publike me vlerë të madhe. Pretendimet kryesore ankimore kane te bëjnë kundër propozimit për dhënie te kontratës. Parashtruesit e ankesave me datën 07 dhe 08.11.2020, kanë parashtruar kërkesa për ri shqyrtim tek AK, megjithatë nuk kemi hasur se përgjigjet përkatësisht vendimet kundrejt te njëjtave kërkesa janë ngarkuar nga AK – Komuna Peje.

Përgjigje ne pretendimet ankimore (Neni 113) Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se disa nga pretendimet ankimore te te dy OE-ve janë te përbashkëta dhe si te tilla do ti trajtojmë.

Pretendim i përbashkët ankimore është aj kundër menaxherit te projektit te prezantuar nga operatori ekonomik i propozuar për dhënie ku kontestohet CV apo përvoja e punës. AK – Komuna Peje, si dëshmi dokumentare ka kërkuar, " *Për menaxher të projektit , diploma e skanuar nga origjinali ose kopja e noterizuar, kontrata e punës, (në rast të angazhimit për këtë projekt, kontrata e menaxherit me ofertuesin duhet të jetë e noterizuar dhe e nënshkruar nga të dy palët në prezencë të noterit) dhe* ***letër referencat për së paku 3 projekte të përfunduara në fushën e rikonstruktimit ose ndërtimit të rrugëve****. CV, në të nënshkruar nga vet ingjinjeri".*

- Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie, si menaxher te projektit ka prezantuar z. Arsim Rapuca, me kualifikim shkollor, inxhinier i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv. Sipas përshkrimit ne CV dhe ne Referencat e prezantuara rezulton qe referencat janë lëshuar kryesisht për projektim te rrugëve, urave dhe ne mbikëqyrje, por jo për menaxhim te projekt te kryer ne rikonstruktimin apo ndërtimin te rrugëve siç është kërkuar nga AK.
- Inxhinieri tjetër i kontestuar / gjeodetin. AK – Komuna Peje, perkës kërkesave te kualifikimit nuk ka kërkuar qe i njëjti duhet te jete i licencuar ne Agjencinë Kadastra le te Kosovës.
- Përderisa për kërkesën nr 6, te kapacitetit teknik dhe profesional operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontratës ka prezantuar certifikatën e lëshuar nga MPMS, ne emër te z. Ndriqim Zeka, ku potencohet se i njëjti me datën 23.05.2019, ka dhëne provimin profesional për Siguri dhe Shëndet ne Pune.
- Po ashtu parashtruesit e ankesave pretendime te përbashkëta kane ngritur edhe kundrejt, disa nga pajisjet e punës te prezantuara nga operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontratës,

përkatësisht, AK, tek aneksi 1, ka përshkruar llojin e pajisjeve, ne pozicionin 2, kontestohet "*Ekskavatori me rrota, me peshe min 15-20 tona me çekan hidraulik*". OE i rekomanduar ne liste ka përshkruar *"Fiat Hitachi, tipi Ex 215W.."*, ku sipas dokumentit unik doganore i njëjti ka peshën prej 24 tona.

- Ne pozicionin 6, është kërkuar, "*Ngarkues, min 2-3m3 (1 cop)*". Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontratës nuk ka prezantuar ndonjë ngarkues te kapacitetit te kërkuar nga AK.
- Ne piken 7, "*Cilindër me min 12-15 tona vibrues*", OE ka prezantuar, rul për shtrimin e rrugëve , jo vibrues me peshe prej rreth 22 ton.
- Ne pozicionin 16, është kërkuar "*Cilindër me rrota te kombinuara (gome dhe hekur) min 6-8 tona (1 cope)*". OE, i propozuar për dhënie nuk ka prezantuar ndonjë dëshmi për pajisje te njëjte sipas kapacitetit te kërkuar nga AK, rrjedhimisht vlerësimi i ofertave nuk është bere ne harmoni me nenin 59, te LPP-se, përkatësisht nuk janë mbuluar kërkesat e vete aplikuara kundrejt ofertuesve. Po ashtu ekzistojnë edhe dëshmi tjera te cilat janë te pa lexueshme si rezultat i skanimit te dobët.

Operatori ekonomik "Granit" shpk – Istog, ka ngritur pretendime ankimore edhe kundrejt ofertuesve tjerë te kualifikuar si te përgjegjshëm por te pa suksesshëm, përkatësisht kundrejt OE "Sallahu"shpk, ku potencohet se i njëjti nuk ka prezantuar dëshmi lidhur me pozicionin nr. 6, te kërkesave te kapacitetit teknik dhe profesional.

OE i njëjte ka prezantuar Certifikate Trajnimi, nga AQSCERT, ne emër te z. Ilmi H. Fetaj, megjithatë AK, ka kërkuar Certifikata për dhënien e provimit profesional nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, e lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Po ashtu i njëjti OE, potencon se Referencat e lëshuara kundrejt, inxhinierit z. Ermir Hasani dhe gjeodetit z. Fadil Shehu, te lëshuara nga OE "Sallahu"shpk janë fiktive. Lidhur me fiktivi tetin e shkresave ne nuk mund te japim ndonjë vlerësim real pasi qe nuk kemi kapacitet teknik apo profesional për vërtitësin e shkresave.

Kontestohet edhe pozicioni nr. 17, i listës se pajisjeve ku AK, ka kërkuar: "Cilindër me rrota hekuri me vibrim me peshe prej min 8-10 tona (2 cope). OE "Sallahu"shpk, sipas shkresave te prezantuara ne oferte ne kemi hasur ne një pajisje te tille jo siç është kërkuar nga AK, megjithatë ekzistojnë edhe dokumente unike doganore tjera te cilat është e pa mundur te lexohen si rezultat i kualitetit te dobët te printimit.

Po ashtu Operatori ekonomik "Granit" shpk – Istog, ka ngritur pretendime ankimore edhe kundrejt ofertës tjerë, përkatësisht kundrejt OE "RSM Company". Kontestohet marrëveshja e lidhur dhe e prezantuar me "Mineral LLC". OE i njëjte ka prezantuar marrëveshjen e njëjta e cila i mbulon kërkesat e AK-se, është përshkruar aktivitetit i prokurimit objekti i marrëveshjes, vulat dhe nënshkrimet e palëve, mos përshkrimi ne marrëveshje qe "pajisjet epen me qira", nuk e bene te pa përgjegjshëm operatorin ekonomik, po ashtu edhe lidhur me referencat e gjeodetit, ne kemi dhen sqarim me larte lidhur me pretendimin për referencat e pretenduara si fiktive.

Ndërsa lidhur me pozicionin 7, 17 dhe 18, te makinerive sqarojmë se i njëjti OE"RSM Company", ka prezantuar listën e pajisjeve dhe te mekanizimit te obligueshëm, ku janë te përshkruara pajisjet, megjithatë dëshmitë dokumentare, dokumentet unike doganore nuk kemi arritur ti administrojmë ne tërësi si rezultat i kualitetit te dobët te skanimit te shkresave, rrjedhimisht disa janë te pa lexueshme.

- Përfundimisht, ne mbështetje te asaj qe u përshkrua si me larte, rekomandimi ynë për AK – Komuna Peje është qe lenden ta kthej ne ri vlerësim me qellim qe te pasqyrohet gjendja reale e ofertave kundrejt kërkesave te vete aplikuara ne dosje te tenderit konform nenit 59, te LPP-se.

Si prova shkresore se bashku me raport gjeni disa kopje te shkresave te ngarkuara nga OE-te, siç janë DUD, Certifikata etj.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve te aprovohen si pjesërisht te bazuara, te anulohet njoftimi, propozimi per dhënie te kontratës dhe lënda te kthehet ne **Ri vleresim**.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Komuna Peje.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - Sallahu shpk - Kaçanik
- Granit shpk - Istog

Provë
Joos Knosaqi

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale/ Ministrarstvo Rada i Socijalne Zaštite/
Ministry of Labour Social Welfare

Nr. regjistrit të certifikatës: 189
Br. registarskog certifikata:
No. of registration certificate

CERTIFIKATË
PËR DHËNIEN E PROVIMIT PROFESIONAL NGA FUSHA E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË
POTVRDA
O POLAGANJU STRUČKOG ISPITA O BEZBEDNOSTI I ZDRAVLJA NA RADU
CERTIFICATE
ON PASSED PROFESSIONAL EXAM ON HEALTH AND SAFETY AT WORK

Emri dhe Mbiemri:
Ime i prezime: NDRIQIM ZEKA
Name and Surname:

Data dhe vendi i lindjes:
Datum i mesto rođenja: 21.04.1993
Date and place of birth:

Adresa e banimit:
Adresa stanovanja: GJAKOVË
Residential Address:

Ka dhënë provimin profesional për Siguri dhe Shëndet në Punë me datë : 23.05.2019
Polagao stručni ispit o Bezbednosti i Zdravlja na Radu datuma:
Passed the professional exam on Health and Safety at Work:

Prishtinë, me: 24.06.2019
Priština, dana:
Pristina:

Ministri/ Ministar/ Minister

Skender Reçica

Joos

- Provo -

Vlen deri: Basu po: Valid to: 09.09.2021	Vlen deri: Basu po: Valid to:
Vula: Dënar: Stamp:	Vula: Dënar: Stamp:
Nënshkrimi i personit zyrtar: Потпис службеног лица: Official signature:	Nënshkrimi i personit zyrtar: Потпис службеног лица: Official signature:
Vlen deri: Basu po: Valid to:	Vlen deri: Basu po: Valid to:
Vula: Dënar: Stamp:	Vula: Dënar: Stamp:
Nënshkrimi i personit zyrtar: Потпис службеног лица: Official signature:	Nënshkrimi i personit zyrtar: Потпис службеног лица: Official signature:
Vlen deri: Basu po: Valid to:	Vlen deri: Basu po: Valid to:
Vula: Dënar: Stamp:	Vula: Dënar: Stamp:
Nënshkrimi i personit zyrtar: Потпис службеног лица: Official signature:	Nënshkrimi i personit zyrtar: Потпис службеног лица: Official signature:

CRA/YPB/VRC 1401364

CRA/YPB/VRC 1401364

REPUBLIKA E KOSOVËS
РЕПУБЛИКА КОСОВО
REPUBLIC OF KOSOVO

RKS

CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT TË AUTOMJETIT
УВЕРЕЊЕ РЕГИСТРАЦИЈЕ ВОЗИЛА
VEHICLE REGISTRATION CERTIFICATE

03-362-GH

CRA/YPB/VRC 1401364

A	Numri i regjistrimit; Број регистрације; Registration number;	03-362-GH
	Data e regjistrimit; Датум регистрације; Date of registration;	08.09.2020
C	Të dhënat personale; Лични подаци; Personal data;	
C.2	Pronari i mjetit; Власник возила; Owner of the vehicle;	
C.2.1	Mbiemri me emri i biznesit; Презиме или пословно име; Surname or business name;	JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.
C.2.2	Emri; Име; Name;	
C.2.3	Adresa; Адреса; Address;	Junik ,, pn .Junik
B	Data e regjistrimit të parë; Датум прве регистрације; Date of first registration;	01.09.1982
D	Automjeti; Возило; Vehicle;	
D.1	Prodhuesi; Произвођач; Make;	MAN
D.2	Tipi; Тип; Type;	19.280 F

D3	Përshkrimi komercial; Комерцијални опис; Commercial description;	N3
E	Numri identifikues i automjetit; Идентификациони број возила; Vehicle identification number;	42246314614
S	Viti i prodhimit; Година производње; Year of production;	1982
S	Kapacitet i ulëseve; Капацитет места за седење; Seating capacity;	2
S.1	Numri i ulëseve; Број места за седење; Number of seats;	
S.2	Numri i vendeve për qëndrim; Број места за стојање; Number of standing places;	
Q	Raporti Fuqi/Peshë [në kW/kg]; Однос Снага/тежина [у kW/kg]; Power/Weight ratio [in kW/kg];	
F	Pesha; Маса; Mass;	16000
F1	Pesha maksimale e ngarkesës së lejuar; Највећа дозвољена маса; Maximum permissible laden mass;	6630
G	Pesha e automjetit; Маса возила; Mass of the vehicle;	9370
K	Homologimi; Хомологација; Type of approval;	

P	Motori; Мотор; Engine;	
P1	Kapaciteti [në cm3]; Запремина [у cm3]; Capacity [in cm3];	11407
P2	Fuqia maksimale neto [në kW]; Максимална нето снага [у kW]; Maximum net power [in kW];	
P3	Lloji i karburantit ose burimi i energjisë; Врста горива или погонског; Type of fuel or power source;	Dizel
R	Ngjyra e automjetit; Боја возила; Color of the vehicle;	X - SHUMËNGJYRËSH
2A	Ndërtimi; Конструкција; Construction;	Automjete për transportimin e ujit me 2 dyer
Shënime; Напомене; Remarks;		

JOOS & KRASNIQI BAZE
Automjet per Transportin e Ujit për pastrimin e Rrugeve

Provë "Sallahu" shpk

AQSCERT
CERTIFICATIONS & ISPECTIONS BODY

CERTIFIKATE TRAJNIMI

Certifikate Nr **AQS/T/S5632017**

Emri i personit te trajnuar **ILMI H. FETAJ**

Datelindja: 15-01-1976

Titulli i Diplomimit "Inxhinier I Ndertimtarise "
Diploma nr 758 dt 22.10.2008

Mori pjesë dhe kaloi me sukses testin final në trajnimin si:

"PËRGJEGJËS PËR SIGURINË DHE MBROJTJEN E SHËNDETIT NË PUNË".

Temat e trajtuara në trajnim:

Moduli 1: 40 orë: Sigurimi teknik i punonjësve dhe masat mbrojtëse në punë;
Moduli 2: 40 orë: Mbrojtja e shëndetit të punonjësve në punë;
Moduli 3: 40 orë: Vlerësimi i riskut në punë.

- Dokumentacioni teknik dhe ligjor që plotësohet në kantier për sigurimin teknik të punonjësve. "Libri i sigurimit teknik"; "Libri i aksidenteve";
- Harmonizimi i skemës së sigurisë dhe mbrojtjes në punë të shoqërive zbatuese të punimeve të ndërtimit me kërkesat e Standartit OHSAS 18001:2007;
- Përshtatja e udhëzimeve të dhëna nga punëdhënësi për kryerjen e punimeve ndërtimore në kantier me synim rritjen e sigurisë në punë;
- Përdorimi i pajisjeve të punës dhe pajisjeve të mbrojtjes personale të punëmarrësve sipas kërkesave të seksionit Nr.6 Aneksi II i VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 " Për sigurinë në kantier";
- Hartimi i Planit Operativ të Sigurisë POS, për vlerësimin e riskut të rrezikut të cilit i ekspozohen punonjësit gjatë punës në kantier, konform kërkesave të seksionit Nr.5 Aneksi II i VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 " Për sigurinë në kantier";
- Masat suplementare në zbatimin e punimeve për punimet e vlerësuara me rrisk të lartë në planin operativ të sigurisë.
- Hartimi i dokumentacionit te vleresimit te riskut ne kompani.

Datat e Trajnimit 15/01- 15/04/2016

Vendi i trajnimit Tirane, Shqiperi

Organizator i trajnimit AQSCERT shpk "Organizem i Vlerësimit të Konformitetit".

Data e leshimit te certifikates Tirane me: 22/04/2016

Vlefshmeria e certifikates mund te kontrollohet ne www.aqscert.org/al/lista-e-personave-te-kualifikuar duke ndjekur udhezimet qe pasqyrohen aty.

Lektori

Technical Direction

For Certification Body
Dr.ess. E.Cani

AQSCERT

AQSCERT sh.p.k. Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla S, kati 02, Ap.09, Tirane, Albania, www.aqscert.org info@aqscert.org

Poovë Joos Kausqi Poovë

1 DEKLARATË	2030 ZBO MERDARE
IM 4	Referenca doganore
3 Formularët 4	R 7661 24/06/2020
1 1	Manifesti 2020 6516
5 Ent&Shd 6 Nr. pakove	7 Numri referenca
1 1	2020 8716

2 Eksportuesi Nr
GEBRUDER MICKENHAGWEN KG
D 58553 HALVER-DE

8 Marrësi / Importuesi Nr 810438095
N.N.T. " A.B.C. "
20 Qershori
Podujevë

9 Personi përgjegjës financiar Nr 810438095
N.N.T. " A.B.C. "
20 Qershori
Podujevë

10 Vend.	11 Vendi i	12 Detajet e vlerës	13 P.P.B
XS nga	XS dg.	2,000.00	0

14 Deklaruesi Nr 810763333
N.T.SH. "ANDI SHPED"
Afrim Zhlia
Podujevë

15 Vendi dërguesi/eksportues: GJERMANIA
15 V.E. Kodi a DE b
17 V.D. Kodi a XK b
16 Vendi origjinës: GJERMANIA
17 Vendi i destinacionit: KOSOVA

18 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit transportues në mënyrën aktive: PZ021MN AA907PZ XS
19 no
20 Kushtet e dërgesës: EXW HALVER

21 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit aktiv transportues që kalon kufirin: PZ021MN AA907PZ XS
22 Valuta dhe shuma e përgjithshme: EUR 38,500.00
23 Kursi i këmbimit: 1.0000000
24 Lloji i: 1 1 transakc.

25 Lloji transportit: 30 në kufi
25 Lloji transportit: 30 Transport
27 Vendi ngarkimit/shkarkimit
28 Të dhëna financiare dhe bankare - Kushtet e pagesës

29 Zyra doganore hyrëse/dalëse: 3031 PKK MERDARE
30 Lokacioni i mallrave

31 Paketimi dho përshkrimi i mallit
Shenja & nr ASC2782003
Kontejner
Numri dho 1 NG
Lloji Pa paketim
Rul per shtrimin e rrugeve, jo vibratorë

Marka:AMMANN,Tipi:ASC200HDPD,Kw:164
Ulese:1,Ngjyra e kalter,ORE Pune 04068.8
Viti i Prodhimit 2010,Perdorur

32 Artikulli 1 Nr.
33 Numri tarifor: 84294030 00
34 Kodi origjinës: a DE b
35 Pesha bruto (kg): 21,975.00
36 Preferenca
37 Procedura: 4000 000
38 Pesha neto (kg): 21,975.00
39 Kuota
40 Dokumenti paraprak/dok. plotësues Nr.
1
41 Njësia plotësuese: PCE 1.00
42 Çmimi për njësi: 38,500.00
43 M.V. 1 kod

44 Inf. shtesë Dokumente Certifikata dhe Autorizime
Nr. Licencës D.Viz. D.Sas
2,000.00+0.00+0.00+0.00-0.00
D.SH. 380 934
380/20010295,Pjes dergess

Kodi LSH
45 Njësimi i mënyrës: 1.000
46 Vlera Statistikore: 40,500.00

47 Llog. taksave taksat

Lloji	Baza e taksës	Norma	Shuma	MP
CD	40,500.000	0.000	0.00	1
VT	40,500.000	18.000	7,290.00	1
		Totali	7,290.00	1

48 Llogaria e pagesës
49 Identifikimi i depos

B DETAJET E LLOGARISË

Mënyra e pagesës	KESH		
Numri i Pranimit	L 7714	Data	24/06/2020
Numri Pagesës	P 4812	Data	24/06/2020
Garancioni	0.00	EUR	Data
Totali shërbimeve	0.00	EUR	
Totali taksave	7,290.00	EUR	

50 Principali Nr Mënyra

C ZYRA E NISJES

51 Zyra zyrat e tranzitit vendi
Përfaqesuar nga:
Vendi dho data:

52 Garancioni nuk vlen
Kodi
53 Zyra e destinacionit dho vendi

D KONTROLL NGA ZYRA DOGANORE E DESTINACIONIT
Vula
Nënshkri
Seksi

54 Vendi dhe data
Deklaruesi emri / përfaqësuesi
LINDITA ABAZI LA8895
"ANDI SHPED"

Provë

RSM

e.pa lexueshme

REPUBLIKA E SHQIPERISE

1 DEKLARATE

Kopje per marresin

8

Enkelejda SPIRU
"LAURA ONE"

E pa lexuesh me

RSM

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Kopje per marresin

1 DEKLARATE

DOGANA SHQ

023010

TE DHENA FINANCIARE

TIRANE

Enkelejda SPIRU
"LAURA ONE"
J 063 / 003

Provë Joos Krasniqi Provë

Dokumenti Unik Doganor

ZYRA E DESTINIMIT

1 DEKLARATË: IM 4

3012 PEJA-TERMINAL

Referenca doganore: R 21880 10/12/2019

Manifesti: 2019 13450

2 Eksportuesi: FATMIR KRASNIQI, GJERMANI

3 Formularët: 1 | 4: 1

5 Emërtimi: 1 | 6 Nr. pakove: 1 | 7 Numri referues: 2019 #663

8 Marrësi / Importuesi: Nr 600490198
" JOOS & KRASNIQI - BAZE " SH.P.K
JUNIK, DEÇAN

9 Personi përgjegjës financiar: Nr 600490198
" JOOS & KRASNIQI - BAZE " SH.P.K
JUNIK, DEÇAN

10 Vend.: DE nga | 11 Vendi i: XS cty. | 12 Detajet e vlerës: 0.00 | 13 P.P.B: 1

14 Deklaruesi: Nr 600086319
N.T.SH. ARDIANI SHPED
NA

15 Vendi dërgues/eksportues: GJERMANIA

15 V.E. Kodi: a DE | b | 17 V.D. Rajoni: a XK | b

16 Vendi origjinës: ITALIA

17 Vendi i destinacionit: KOSOVA

18 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit transportues në nisje/arritje: VR063JA AB305VR | XS | 19: no

20 Kushtet e dërgesës: EXW GJERMANI

21 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit aktiv transportues që kalon kufirin: VR063JA AB305VR | XS

22 Valuta dhe shuma e përgjithshme: EUR 15,100.00

23 Kursi i këmbimit: 1.0000000

24 Lloji i: 1 | 1 | transakc.

25 Lloji transportit: 30 | në kufi

26 Lloji transportit: 30 | Transport

27 Vendi ngarkimit/shkarkimit:

28 Të dhëna financiare dhe bankare - Kushtet e pagesës:

29 Zyra doganore hyrëse/dalëse: 3041 PKK DHEU I BARDHË

30 Lokacioni i mallrave:

31 Paketimi dhe përshkrimi i mallit

Shenjat dhe numrat - Nr i kontenierit - Numri dhe lloji

Shenja & nr: ZEF208W1A00000070

I pakove: ESKAVATOR ME LUGE +2LUG+2ÇEKIÇA

Numri dhe Llojit: 1 NG

Pa paketim

Makineritë me rrotullim të superstrukturës 360°, eskavatorët track - laying

Marka:FIAT HITACHI.Tipi:EX 215W K763
KW:107.Ngjyra:E PORTOKALLËT
Viti i prodhimit:2001.Ore pune/9791

32 Artikuli: 1 | No.

33 Numri tarifor: 84295210 | 00

34 Kodi origjinës: a IT | b

35 Pesha bruto (kg): 24,000.00

36 Preferenca:

37 Procedura: 4000 | 000

38 Pesha Neto (kg): 22,000.00

39 Kuota:

40 Dokumenti paraprak/dok. plotësues: 1

S/L

41 Njesia plotësuese: PCE 1.00

42 Çmimi për njësi: 15,100.00

43 M.V.: 6 | kodi

44 Inf. shtesë Dokumente Certifikata dhe Autorizime

Nr. Licencës | D.Vle. | D.Sas

4,000.00+0.00+0.00+0.00-0.00

D.SH. 380 934

380/039

Kodi I.SH. | 45 Rregullimi: 1.266

46 Vlera Statistikore: 24,180.60

47 Llog. taksave taksat

Lloji	Baza e taksës	Norma	Shuma	MP
CD	24,180.600	0.000	0.00	1
VT	24,180.600	18.000	4,352.51	1
		Totali	4,352.51	1

48 Llogaria e pagesës

49 Identifikimi i depos

B DETAJET E LLOGARISË

Mënyra e pagesës	KESH		
Numri i Pranimit	L 21877	/ Data	10/12/2019
Numri Pagesës	P 14037	Data	10/12/2019
Garancioni	0.00	EUR	Data
Totali shërbimeve	0.00	EUR	
Totali taksave	4,352.51	EUR	

50 Principali: Nr | Nënshkri

C ZYRA E NISJES

51 Zyra zyret e tranzitit vendi

Përfaqesuar nga:
Vendi dhe data:

52 Garancioni i

Kodi | 53 Zyra e destinacionit dhe vendi

D KONTROLL NGA ZYRA DOGANORE E DESTINACIONIT

Vula:

54 Vendi dhe data

Nënshkri

Deklaruesi emri / përfaqësuesi
ARDIAN KOSHUTANI AK7034